

1.3 Vendndodhja

Bashkia e Pustecit ben pjese ne rrethin dhe qarkun e Korçes dhe ndodhet ne skajin verilindor te Qarkut.

Bashkia kufizohet ne perendim me bashkite Pogradec dhe Maliq, ndersa ne veriperendim dhe lindje me Republiken e Maqedonise dhe ne jug e juglindje me Greqine.


Kryeqendra e bashkise se re eshte fshati i Pustecit, i cili ndodhet 25 km larg nga qyteti i Korçes. Bashkia e re e Pustecit perbehet nga nje njesi administrative. Kjo per shkak se reforma territoriale aplikoi kriteret e veçanta qe lidhen me shumicen e popullise etnike qe jeton ne territorin e bashkise. Perndryshe, Bashkia e re e Pustecit eshte ish komuna Liqenas, emer zyrtar qe u perdor ne periudhen kohore 1973-2013.

Bashkia ka nen administrimin e saj 9 fshatra, te cilat jane: Pustec, Shulin, Leska, Zaroshka, Cerje, Gorice e Madhe, Gorice e Vogel, Diellas, Gollomboc, te cilat shtrihen ne nje gjatesi prej 45 km.

Territori i bashkise shtrihet ne nje siperfaqe prej 1363.8 ha. Dendesia e popullise eshte 94 banore/km². Fshati me i madh per nga siperfaqja eshte qendra e bashkise, Pusteci si dhe fshati Gorica e Madhe. Keto fshatra, te dyja se bashku, perfaqesojne 35% te territorit te bashkise.

Territori i bashkise perkon me pellgun ujembledhes te liqenit te Prespes, i cili ka statusin e Parkut Kombetar te Prespes, zone e mbrojtur ne nivel nderkombetar.

Fshatrat jane te shperndare ne te gjithë territorin e bashkise duke pasur si qender organizimi liqenin. Shumica e fshatrave shtrihen buze tij dhe perreth tij. Nje pjese e vogel e fshatrave shtrihen pak me larg, ndersa Cerje eshte fshati qe ndodhet ne terren malor.



1.4 Kushtet Klimatike dhe Hidrologjike te zones.

1.4.1 Regjimi I Temperatures Se Ajrit

Siç e permendem dhe me siper, pozicioni gjeografik dhe format e ndrysheme te relievit reflektohen ndjeshem ne kushtet klimatike te zones, dhe sidomos ne vlerat e temperaturave te ajrit. Nje perfytyrim te pergjithshem te regjimit termik te nje zone jep shqyrtimi i vlerave mesatare vjetore te temperatures.

Konkretisht, temperaturat mesatare vjetore luhetet nga 4°C deri ne 10 °C. Keto jane vlera mesatare te nxjerra nga nje seri e gjate vrojtimesh (30, 40 vjet) te pranuar nga Organizata Boterore e Meteorologjise.

Per te evidentuar ecurine brendavjetore te ajrit le t'i referohemi tab2.1.1 ne te cilen jepen vlerat mesatare te temperatures se ajrit per çdo muaj ne zonen e Pustecit.

Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
°C	1	4	6	10	13	17	19	20	16	10	6	2

Tab. 2.1.1 Temperatura mesatare mujore e ajrit

Siç shihet temperatura mesatare ka nje ecuri normale me nje maksimum ne muajt e veres dhe minimum ne muajt e dimrit.

Keshtu muaji me i ftohte i vitit eshte Janari ku temperaturat mesatare eshte 1°C. Ndersa muaji me i ngrohte eshte muaji gusht me vlere te temperatures mesatare 20°C.




Figure 2.1.2. Ecuria brendavjetore e temperatures mesatare ajrit

1.4.2 Reshjet atmosferike

Reshjet mesatare vjetore jane rreth 950 milimeter. Per periudhen e ngrohte (Prill-Shtator) rreshjet mesatare te shiut jane rreth 300 milimeter dhe per periudhen e ftohte (Tetor-Mars) rreshjet mesatare te shiut jane rreth 650 milimeter.

Po te studiojme shperndarjen brendavjetore te reshjeve ne kete zone verejme qe kjo shperndarje eshte e pabarabarte ne periudha te ndryshme te vitit. Sasia me e madhe e reshjeve bie gjate gjysmes se ftohte te vitit rreth 70%, nderkohe qe gjate muajve te veres sasia e tyre eshte me e vogel, rreth 30%. Kjo shperndarje lidhet me veprimtarine e theksuar ciklonare gjate muajve te ftohte te vitit, e cila shoqerohet me mot me vranesira dhe reshje te bollshme.

Ne tabelen e meposhteme jepen sasite per çdo muaj te reshjeve qe bien ne kete zone. Keto vlera jane rezultat i perpunimit te serive shumevjeçare te reshjeve (30,40 vjet), seri vrojtimesh e pranuar nga Organizata Boterore e Meteorologjise per kryerjen e studimeve klimatike te nje rajoni te dhene.

muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Rreshjet	100	85	70	60	55	50	30	35	60	130	145	150

Tab. 2.1.2 Sasia mujore shumevjeçare e reshjeve




Fig. 2.1.3 Ecuria brendavjetore e reshje

Siç shihet nga te dhenat e tabelës 2 dhe nga paraqitja grafike fig. 2.1.3, shpërndarja e reshjeve gjatë vitit ka formën e “U” që shpreh qartë regjimin mesdhetar të reshjeve.

Një tregues i rëndësishëm dhe i dobishëm për qëllime hidroteknike dhe urbanistike është sasia e reshjeve maksimale 24 orëshe dhe reshjet maksimale për intervale të tjera kohorë për periudha të ndryshme përsëritje.

Duke u mbeshtetur ne serite e vlerave maksimale te reshjeve te rena gjate 24 oreve jane llogaritur vlerat e pritura te intensiteteve te reshjeve per periudha te ndryshme perseritje.

	<i>Periudha e perseritjes (vjet)</i>				
<i>Int. Orar</i>	<i>100</i>	<i>50</i>	<i>20</i>	<i>10</i>	<i>4</i>
<i>24</i>	<i>169.0</i>	<i>152.0</i>	<i>120.0</i>	<i>102.0</i>	<i>79.2</i>

Tab Intensiteti i reshjeve per siguri te ndryshme

Konkretisht (per stacionon Pustecs), brenda 24 oreve pritet te bien 169.0 mm shi per sigurine 1% (periudha e perseritjes 1 here ne 100 vjet), ndersa per sigurine 10% (periudha e perseritjes 1 here ne 10 vjet) pritet te bien 102.0 mm.

1.5 Rilevimi Topografik


Per hartimin e relievit te zones, ekipi i inxhinierëve topografeve eshte angazhuar per kryerjen e matjeve topografike ne terren. Ne baze te ketyre matjeve eshte hartuar planimetria e gjendjes ekzistuese ne shkallen 1:500 dhe profilet gjatesore, qe do te sherbejne si baze per studimin dhe projektimin e objektit.





Planet e Rilevimit Topografik

Tuminec / Kallamas




Gorna Gorica / Gorica e Madhe




Gorice e Madhe-Lagjia re




Dolna Gorica / Gorica e Vogel




Globocen / Gollomboc




Shulin / Diellas




Pustec



Leska / Lajthize



Zrnovsko / Zaroshke



2 ZGJIDHJA E PROJEKTIT

2.1 Ndertimi K.U.Z. Pustec

Per ndertimin e rrjetit te ri KUZ ne zonen e Pustecit eshte zgjedhur perdorimi i tubave te polietilenit te brinjezuar (korrogato) me diameter D 200-600 SN8. Rrjeti kryesor i transmetimit te ujrave te zeza do te shkarkoje ne Gropa Septike dhe me pas me kanal drenazhi me gure dhe beton, ndersa ne rastet kur rrjeti KUZ shkarkon liqen, ujrat e zeza do te procesohen permes Impianteve dhe kanaleve te drenzhit butobeton.

Gjurma e tubacioneve eshte percaktuar duke marre ne konsiderate faktore te ndryshem si me poshte:

- Pozicioni i rrjeteve ekzistuese,
- Pozicioni i pusetave ekzistuese KUZ,
- Akset ekzistuese te kanaleve te hapura,
- Rrjeti ekzistues rrugor,
- Pozicioni i shtyllave te tensionit,
- Minimizimi i prishjeve ne rruge asfalti.

Fshatrat, ujrat e zeza te cilave do te trajtohen me Grope Septike jane:


- Gorna Gorica / Gorica e Madhe
- Tuminec / Kallamas
- Shulin / Diellas
- Leska / Lajthize
- Zrnovsko – Zaroshke

Te dhenat e Gropes Septike:


Gropat Septike jane parashikuar 100 dhe 200 m3 ne varesi te numrit te popullsise aktuale dhe rritjes se popullsise me 1.5% per 20 vite

PRERJA GJATESORE E GROPES SEPTIKE

PRERJA 1 - 1



PLANIMETRIA E GROPES SEPTIKE



Fshatrat, ujrat e zeza te cilave do te trajtohen me Impiante jane:

- Dolna Gorica / Gorica e Vogel – 1 Impiant (300 persona)
- Gorice e Madhe-Lagjia re – 1 Impiant (300 persona)
- Globoceni / Gollomboc – 1 Impiant (700-750 persona)
- Pustec – 1 Impiant (1600-1650 persona)




Te dhenat e Impiantit jane:




Impianti BIOBLOK është një trajtim i plotë biologjik i përbërë nga një seksion parësor sedimentimi dhe tretjeje dhe një seksion i trajtimit biologjik masiv të ngjitur (MBBR), një reaktor biologjik, brenda të cilit mikroorganizmat që pastrojnë efluentin zhvillohen në sipërfaqen e posaçme, material mbushës me shumicë (media filtri).


Shpërndarja uniforme e efluentit përmes filtrit garanton kontaktin maksimal midis materialit organik për t'u pastruar dhe filmit biologjik që mbulon sferat që përbëjnë materialin mbushës. Seksioni MBBR konsumon ngarkesën organike në efluent në prani të oksigjenit, i cili vazhdimisht hyn në rezervuar përmes kompresorit të jashtëm dhe shpërndahet nga pllakat e difuzorit.

Impianti BIOBLOK përdoret si trajtim parësor dhe dytësor i efluentëve shtëpiake dhe të ngjashme. Ato duhet të paraprihen nga një fazë e ndarjes së yndyrës në mënyrë që të mund të trajtohet edhe uji gri.





Shembull instalimi:



- Artikull specifik

Impiante për trajtimin e ujërave të zeza shtëpiake ose të ngjashme, të ndërtuara në polietileni një copë (PE) nga një kompani e certifikuar ISO 9001/2008, në përputhje me Dekretin Legjislativ nr. 152 të vitit 2006 për shkarkimin e efluentit të trajtuar në tokë, për instalimin nëntokësor në rrjedhën e poshtme të trajtimit primar të ndarjes së yndyrës së ujit gri të kuzhinës dhe banjës. Përbëhet nga një seksion i sedimentimit dhe tretjes anaerobe të llumit, një trajtim biologjik i njëpasnjëshëm me një seksion trajtimi biologjik masiv të ngjitur (MBBR) i kompletuar me një medium filtri PP izotaktik të zi me sipërfaqe të madhe.

Hyrja përbëhet nga një tub i shpuar në PVC me guarnicione të papërshkueshme nga uji për furnizimin me gravitet të efluentit nga lart, ndërsa dalja përbëhet nga një tub PVC me copë litari të papërshkueshme nga uji dhe tub me vrima të zhytur për nxjerrjen e efluentit të trajtuar; prania në pjesën e poshtme të pllakave shpërndarëse mikrofluskash të imëta për ajrimin e detyruar të medias së filtrit, të lidhura me zorrë gome me një ventilator/kompresor, të instaluar nga jashtë.

Rezervuari është gjithashtu i pajisur me një ventilim të biogazit dhe mbulesa të pusetave për inspektim, mirëmbajtje; Zgjatjet opsionale mund të instalohen në vrimat e inspektimit.

Pastrimi i Impianteve dhe Gropave Septike do të realizohet me mjetet e nevojshme si: motopompat dhe autoboteve në intervale kohore 1 herë në 6 muaj.